



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Drejtoria për Buxhet dhe Financa  
Odelenje za Budžet i Finansije-Department of Budget and Finance

RAPORTI I PUNËS JANAR-MARS 2026

## Përmbajtja

<b>HYRJE.....</b>	<b>3</b>
<b>1. SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA.....</b>	<b>3</b>
<b>2. BUXHETI 2026.....</b>	<b>4</b>
<b>3. PUNËT E REALIZUARA JANAR - MARS .....</b>	<b>4</b>
<b>4. JANAR-MARS BUXHET,ALOKIM,SHPENZIM .....</b>	<b>5</b>
4.1 Paraqitja grafike.....	5
<b>5. TË HYRAT VETANAKE .....</b>	<b>6</b>
<b>6. SEKTORI I TATIMIT NË PRONË .....</b>	<b>6</b>

## HYRJE

- Ky raport përfshinë të dhënat për periudhën Janar- Mars 2026 nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, konkretisht nga sektori për Buxhet dhe Financa dhe sektori i Tatimit në Pronë.

## 1. SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA

- Bazuar në obligimet ligjore të cilat dalin nga Ligji mbi Financat Publike dhe Përgjegjësitë ne si drejtori, konsiderojmë se kemi kryer të gjitha detyrat dhe obligimet që i takojnë kësaj drejtorie.
- Në Drejtorin e Financave kemi arritur që detyrat të kryhen në afate ligjore dhe çdo e hyre dhe shpenzim të evidentohet, në sistemin e SIMFK dhe data bazën e brendshme.
- Gjate kësaj periudhe të punës kemi mbajtur disa takime me Ministrinë e Financave, me AKK dhe organizata të ndryshme apo donator që kryesisht janë trajtuar çështjet financiare.
- Tek shpenzimet Operative kemi arritur të kursejmë disa shpenzime pa e dëmtuar procesin e punës, duke i rritur disa shpenzime-shërbime të cilat në të kaluarën janë paguar nga Kapitalet e realisht kanë qenë Mallra dhe Shërbime, siç janë, mirëmbajtja e ndërtesave , mirëmbajtja e rrugëve, sinjalizimet horizontale dhe vertikale, rrënimet e ndërtimeve pa leje, hartimi i projekteve, mbikëqyrja e projekteve etj, duke respektuar kodet dhe kategoritë ekonomike, si dhe afate ligjore të cilat janë të rregulluara me ligjet për Financat Publike.

## 2. BUXHETI 2026

➤ **Buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2025 ndahet në dy fonde burimore:**

- Grandi i qeveritar ..... 19,296,320 €
  - Të hyrat vetanake ..... 2,251,414 €
- Gjithsej buxheti fillestar:..... 21,547,734 €

➤ **Buxheti për vitin 2026 i shpërndarë sipas kategorive ekonomike:**

- Paga dhe Mëditje ..... 12,454,555 €
- Mallra dhe Shërbime..... 2,761,006 €
- Shpenzime Komunale .....390,000.00 €
- Subvencione dhe Transfere ..... 1,000,000 €
- Investime Kapitale..... 4,942,173 €

**Totali: 21,547,734 €**

## 3. PUNËT E REALIZUARA JANAR - MARS


➤ **Gjatë kësaj periudhe kemi realizuar këto detyra:**

- Zotime, pranime, shpenzime për Mallra dhe Shërbime, shërbime komunale, subvencione dhe transfere, dhe investime kapitale dhe përgatitja e ndryshimeve në listën e pagave për punëtor.
- Bartja e të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin 2026.
- Shpërndarja e faturave të tatimit në pronë
- Përgatitja e raportit financiar në baza tremujor 2026 për Kuvendin Komunal dhe Kryetarin e Komunës.
- Raportimi i obligimeve financiare, dhe kontraktuale në baza mujore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.
- Përgatitja e raporteve mujore dhe tremujore (shpenzimet dhe të hyrat) për publikim në Web faqen e Komunës

## 4. JANAR-MARS BUXHET,ALOKIM,SHPENZIM

Përshkrimi	Lëndët e kryera	Buxheti aktual	Alokimet	Shpenzimet	Shpenzim/Buxheti aktual %	Shpenzim/Alokim %
<b>Paga dhe Mëdtije</b>	-	12,454,555.00	3,977,230.79	3,977,230.79	31.93	100.00
<b>Mallra dhe Shërbime</b>	724	2,761,008.00	2,561,008.00	859,436.14	31.13	33.56
<b>Shpenzime Komunale</b>	86	390,000.00	390,000.00	146,117.22	37.47	37.47
<b>Subvencione dhe Transfere</b>	43	1,000,000.00	159,119.72	140,960.72	14.10	88.59
<b>Investime Kapitale</b>	2	4,948,540.66	3,897,126.66	2,846,286.56	57.52	73.04
<b>Totali</b>	<b>855</b>	<b>21,554,103.66</b>	<b>10,984,485.17</b>	<b>7,970,031.43</b>	<b>36.98</b>	<b>72.56</b>

### 4.1 Paraqitja grafike



## 5. TË HYRAT VETANAKE

- Të hyrat e përgjithshme vetanake të planifikuara për vitin 2026 janë 2,251,414.00 euro, për këtë periudhë janë realizuar në shumë 272,285.68 euro apo 12.09 % të planifikimit vjetor.

## 6. SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

- Gjatë periudhës Janar-Mars 2026 sektori i tatimit në pronë ka realizuar të hyra në shumë prej 72,148.01 euro apo 9.25 % të planifikimit vjetor (planifikimi vjetor 779,432.00).
- Regjistrimet e reja janë 62 objekte, ose 12,415 m<sup>2</sup>. Verifikimi i objekteve 1211 ose 1979,83 m<sup>2</sup>.

**VËREJTJE:** Për arsye të përditësimit të programit të Tatimit në Pronë nga departamenti i Tatimit në Pronë nuk ka qënë e mundur te gjenerohen të gjitha të dhënat e kërkuara për raport!

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

---